



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 30.1.2025

Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 9, të Vendimit nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, si dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 4 (katër) pozicione të lira Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD për Masën 1 dhe Masën 11, në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6520>

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 1 (një) pozicion i lirë Inspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD për Masën 3, Masën 4 dhe Masën 7, në Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6520>

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbim civil 3 (tre) pozicione të lira Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6519>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil, apo kandidatë për pranim në

shërbimin civil të aplikojnë për pozicionet vakante të shpallura. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL